



## KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

---

NJOFTIM I DATËS 25.05.2023

**PËR  
SHPALLJEN E PROCEDURËS SË NGRITJES NË DETYRË  
NË GJYKATËN E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM, PËR NJË  
POZICION TË LIRË NË FUSHËN E TË DREJTËS CIVILE**

- 1. Këshilli i Lartë Gjyqësor, me Vendimin nr. 239, datë 24.05.2023, ka vendosur:**
  - *hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të përgjithshëm, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.*
- 2. Këshilli i Lartë Gjyqësor, me Vendimin nr.240 , datë 24.05.2023, ka vendosur:**
  - *hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të përgjithshëm, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.*
- 3. Këshilli i Lartë Gjyqësor, me Vendimin nr. 241, datë 24.05.2023, ka vendosur:**
  - *hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të përgjithshëm, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.*
- 4. Këshilli i Lartë Gjyqësor, me Vendimin nr. 242, datë 24.05.2023, ka vendosur:**
  - *hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të përgjithshëm, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.*
- 5. Këshilli i Lartë Gjyqësor, me Vendimin nr.243 , datë 24.05.2023, ka vendosur:**
  - *hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të përgjithshëm, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.*
- 6. Këshilli i Lartë Gjyqësor, me Vendimin nr. 244, datë 24.05.2023, ka vendosur:**
  - *hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të përgjithshëm, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.*

**7. Këshilli i Lartë Gjyqësor, me Vendimin nr. 245, datë 24.05.2023, ka vendosur:**

- hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të përgjithshëm, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.

**8. Këshilli i Lartë Gjyqësor, me Vendimin nr.246 , datë 24.05.2023, ka vendosur:**

- hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të përgjithshëm, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.

**9. Këshilli i Lartë Gjyqësor, me Vendimin nr.247, datë 24.05.2023, ka vendosur:**

- hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të përgjithshëm, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.

Me këto vendime Këshilli i Lartë Gjyqësor ka *shpallur kërkesën për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve që plotësojnë kriteret ligjore për ngritjen në detyrë në gjykatën e Apelit.*

**Këshilli i Lartë Gjyqësor fton:**

**Çdo gjyqtar që është në një pozicion në një gjykatë të shkallës së parë ose në një pozicion të komanduar, i cili plotëson kriteret ligjore të ngritjes në detyrë në gjykatën e apelit, për të marrë pjesë në këtë procedurë ngritjeje në detyrë dhe të paraqesë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor dokumentacionin e nevojshëm të përcaktuar në vendimin e sipërcituar të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe të pasqyruar edhe më poshtë.**

**Kriteret ligjore që duhet të plotësojë kandidati për t’u ngritur në detyrë në gjykatën e apelit, në një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile, përcaktohen në pikën 3, të nenit 8, në pikën 4, të nenit 47, si dhe në pikat 7 dhe 8, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si më poshtë:**

- a) Kandidati duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet në shkallën e parë, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës civile, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar;
- b) Kandidati duhet të kalojë me sukses procesin e verifikimit të pasurisë dhe të figurës, sipas Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”;
- c) Kandidati duhet të mos ketë masë disiplinore në fuqi;

- ç) Kandidati duhet të mos jetë në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Plotësimi i kriterëve të kandidimit do të verifikohet sipas kërkesave dhe procedurës së përcaktuar në vendimin e sipërcituar të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**Në momentin e aplikimit kandidati duhet të paraqesë këto dokumente:**

- a) Kërkesën për shprehjen e interesit për të kandiduar për pozicionin e lirë të shpallur, duke e identifikuar atë përmes numrit të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor;
- b) Jetëshkrimin, me të dhënat e plota të kontaktit (numër telefoni/e-mail);
- c) Fotokopje të kartës së identitetit;
- ç) Vetëdeklarim për mospasjen masë disiplinore në fuqi, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi;
- d) Vetëdeklarim për mosqenien në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi.

**Afati i paraqitjes së kërkesës me dokumentacionin shoqërues është deri më datë 14.06.2023.**

**Dokumentacioni i aplikimit duhet të dorëzohet nga kandidati në Zyrën e Protokollit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, në adresën: Rruga “Ana Komnena”, Godina “Poli i Drejtësisë”, Tiranë.**

Pas përfundimit të afatit të kandidimit, lista e kandidatëve do të publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Të gjithë të interesuarit për më tepër informacion lidhur me procedurat e kandidimit mund të vizitojnë faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, **duke u konsultuar me Vendimet e tij nr. 239, nr.240, nr.241, nr. 242, nr.243 , nr.244 , nr. 245, nr. 246, dhe nr.247, datë 24.05.2023.**

**Kujdes:**

***Në zbatim të pikës 6, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar:***

- *Në procedurat e ngritjes në detyrë në një gjykatë më të lartë mund të kandidojë çdo gjyqtar që plotëson kriteret ligjore, pavarësisht faktit nëse ka kandiduar në procedura të mëparshme ngritjeje në detyrë.*
- *Në çdo rast, kandidati nuk mund të kandidojë në më shumë se tre pozicione të lira që janë në proces, pavarësisht kohës së shpalljes së tyre, qenies së tyre në të njëjtën gjykatë apo në të njëjtën fushë të së drejtës, qofshin këto procedura të ngritjes në detyrë ose lëvizje paralele.*
- *Nëse magjistrati kandidon për më shumë se tri pozicione të lira në proces, kandidime të vlefshme konsiderohen ato të bëra më parë në kohë, ose në rastin e shumë kandidimeve në të njëjtën kohë, ato sipas radhës kronologjike të pozicioneve të shpallura, duke filluar nga ai i shpallur më parë. Magjistrati që kandidon për më shumë se një pozicion, bën renditjen e tyre sipas preferencës.*
- *Kandidimi për një pozicion të lirë për të cilin procedura e ngritjes në detyrë është finalizuar ose kandidimi i tërhequr, nuk llogariten si kandidime për efekt të të drejtës së kandidimit në jo më shumë se tre pozicione të lira.*